

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

Kontabiliteti Menaxherial
Zgjidhjet

P2



FLETË PROVIMI

Data 20.01.2018

PËRMBAJTJA

Pjesa	Maksimumi i Dhënë	-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga <u>ShKÇAK-PIKËT E DHËNA</u>
1. Problemi 1	20	
2. Problemi 2	20	
3. Problemi 3	20	
4. Problemi 4	20	
5. Problem 5	20	
Total	100	

Problemi 1

Pjesa A

Eni Co. ka paraqitur informatat në lidhje me sasinë e shitjeve dhe shpenzimeve :

	Janar	Qershor
Shitjet në njësi	45,200	65,820
Kostot që lidhen me shitjet	110,420	150,629

Kalkuloni sa kanë qenë kosto variabile për njësi për Kostot që lidhen me shitjet : (5 pikë) (Rrumbullakos vlerat)

Pjesa B

Eni Co ka paraqitur rezultatet si më poshtë:

	€
Çmimi i shitjes për njësi	45
Kosto variabile për njësi	27
Total kostot fikse në muaj	45,252
Shitjet e pritur në mars	3,270 njësi

Kërkohet:

1. Kalkuloni pikën e rentabilitetit në njësi : (5pikë)
2. Kalkuloni marxhinen e sigurisë në %: (5 pikë)
3. Kalkuloni sa njësi duhet shitur për të arritur një fitim prej 16,400€ : (5 pikë)

Zgjidhja 1

A. 1.

	Shitjet në njësi	Kostot që lidhen me shitjet
Janar	45,200	110,420
Qershor	<u>65,820</u>	<u>150,629</u>
Ndryshimi	20,620	40,209

Kosto Variabile për njësi = $40,209 / 20,620$ njësi = 1.95 për njësi

B. 1. Pika e rentabilitetit

$$= 45,252 / (45-27)$$
$$= 2,514 \text{ njësi}$$

2.

Marxhina e sigurisë

$$= \frac{3,270 - 2,514}{3,270} \times 100 = 23.12\% \text{ ose } 23\%$$

3. Shitjet e kërkuara në njësi =

$$= \frac{45,252 + 16,400}{(45-27)} = 3,425.11 \text{ ose } 3,425 \text{ njësi}$$

Problemi 2

Kontabilisti i kostove i kompanisë Sport Co. ka vështirësi të përgatis raportin për Bordin e drejtoreshë të kompanisë dhe ka kërkuar ndihmë nga ju. Kërkesa është që të përgatiten analizat e variancave. Juve ju është ofruar buxheti dhe informatat aktuale për muajin mars (shiko të dhënat e mëposhtëmve).

Informatat për buxhetin për muajin Mars :

Prodhimi në njësi	25,000
Materiali direkt (250,000 Kg)	362,500
Puna direkte (87,500 orë)	1,089,375
Shpenzimet e përgjithshme variable	271,250

Rezultatet aktuale të regjistruara për muajin Mars:

Prodhimi në njësi	27,000
Materiali Direkt (263,250 Kg)	394,875
Puna Direkte (97,200 orë)	1,190,700
Shpenzimet e përgjithshme variable	306,180

Shenim:

1. Kostot fikse të përgjithshme të prodhimit aktuale për Mars janë 172,400€.
2. Kostot fikse të përgjithshme të prodhimit të buxhetuara për muaj ishin 175,000 €.
3. Kostot variable të prodhimit absorbohen në produkt bazuar në numrin e orëve të buxhetuara të orëve direkte të punës.

KËRKOHET:

- (a) Përgatisni koston standarde për njësi dhe përgatisni pasqyrën e kostove të buxhetit fiks, buxhetit fleksibil dhe rezultateve aktuale. (6 pikë)
- (b) Kalkuloni variancat relevante duke paraqitur kalkulimet detale. (14 pikë)

[Total: 20 Pikë]

Zgjidhja 2

a) Pasqyra e kostove

Kosto standarde për njësi

	€	
Materiali direkt 10kg x €1.45 për kg	14.50	
Puna direkte 3.5 orë x €12.45 për orë	43.575	
Shpp Variabile 3.5 orë x €3.10	<u>10.85</u>	
Kosto variabile e produktit	<u>68.925</u>	(2 pikë)

Njësi	25,000	27,000	27,000
	<u>Fiks</u> €	<u>Fleksibil</u> €	<u>Aktual</u> €
Materialet direkte	362,500	391,500	394,875
Puna direkte	1,089,375	1,176,525	1,190,700
Shpp Variabile	<u>271,250</u>	<u>292,950</u>	<u>306,180</u>
Kostot totale variabile	1,723,125	1,860,975	1,891,755
Shpp fikse	<u>175,000</u>	<u>175,000</u>	<u>172,400</u>
Kostot totale të prodhimit	<u>1,898,125</u>	<u>2,035,975</u>	<u>2,064,155</u>
	(1 pikë)	(2 pikë)	(1 pikë)

(6 pikë)

b) Kalkulimi i variancave

Materialet direkte

Varianca e cmimit
= $[\text{€}1.45 - (\text{€}394,875 / 263,250)] \times 263,250 =$ -13,162.5 A

Varianca e përdorimit
= $[(10 \times 27,000) - 263,250] \times \text{€}1.45 =$ 9,787.5 F

Puna direkte

Varianca e çmimit
= $[\text{€}12.45 - (\text{€}1,190,700 / 97,200)] \times 97,200 =$ 19,440 F

Varianca e efikasitetit
= $[(3.5 \times 27,000) - 97,200] \times \text{€}12.45 =$ -33,615 A

Varianca e shpp variabile

Varianca e çmimit

$$= [€3.10 - (€306,180/97,200)] \times 97,200 = -4,860 \text{ A}$$

Varianca e efikasitetit

$$= [(3.5 \times 27,000) - 97,200] \times €3.10 = -8,370 \text{ A}$$

Varianca e shpp filse

Varianca e shpenzimit

$$= [175,000 - 172,400] = 2,600 \text{ F}$$

(7 x 2 = 14 pikë)

Problemi 3 (20 pikë)

Kompania CC është duke vepruar aktualisht me 80% të kapacitetit të saj maksimal prej 250 orë direkte të punës në ditë. Kompania e prodhon një produkt të vetëm dhe i shet të gjitha prodhimet e saj të rregullta, dhe parashikon se ajo do të jetë në gjendje të mbajë këtë nivel të shitjes edhe në të ardhmen. Kompania është duke kërkuar mënyra për të shfrytëzuar kapacitetet e tepërta dhe aktualisht po e shqyrton një propozim për të prodhuar 10.000 njësi, si një porosi e veçantë. Porosia duhet të përfundojë për 60 ditë. Çmimi për porosinë e veçantë për njësi është € 7,50. Çmimi i shitjes i rregullt për këtë produkt është 10,50 €. Shpenzimet variabile për njësi janë:

Materialet Direkte	€2.50
Puna direkte (për 1/2 orë)	€3.00
Kosto variabile e përgjithshme	€1.50
Kostot variabile të shitjes	€0.50

Kostot fikse vjetore janë 72,000 €. Kompania nuk do të merr në konsideratë punën jashtë orarit për arsyeje të politikës së menaxherit të prodhimit dhe nëse porosia e veçantë pranohet duhet të shfrytëzojë kapacitetet në dispozicion. Asnjë kosto e shitjeve apo kosto tjera administrative nuk ndërlidhen me porosinë e veçantë. Gjithsesi porosia e veçantë duhet të përfundojë brenda afatit 60 ditor dhe numri i njësive duhet të jetë 10,000 njësi.

a. Tregoni nëse porosia e veçantë duhet të pranohet. Trego të gjitha llogaritjet (14 pikë)

b. Llogaritni me çfarë çmimi për njësi për njësi të porosis së veçantë do të jetë indiferent CC ndërmjet pranimit apo refuzimit të porosis së veçantë. (6 pikë)

Zgjidhja e problemit 3

Kostot fikse janë jo relevante për këtë kalkulim dhe duhet injoruar

a. Kontributi për porosit e rregullta dhe të veçanta është :

	Shitjet e rregullta	Shitjet e veçanta
Çmimi	10.5	7.5
Materialet Direkte	2.5	2.5
Puna Direkte	3.0	3.0
Variabile të përgjithshme	1.5	1.5
Kosto e shitjeve	0.5	0.0
Kontributi marginal	3.0	0.5

Me pranimin e ofertës special kërkohet kapaciteti prej $10,000 \times 0.5 = 5,000$ orë

Kapaciteti i tanishëm 20% i pa shfrytëzuar $0.2 \times 250 \times 60 = 3,000$ orë në dispozicion për 60 ditë. Nga kjo 2,000 orë duhet të shfrytëzohen nga porosia e rregullt për të prodhuar porosinë e veçante.

$2,000 \times 1 / 0.5 = 4,000$ njësi nga porosit e rregullta. Nëse i krahasojmë të dhënat, ne shohim :

Kontributi nga porosia e veçantë	$(10,000 \times €0.50)$ € 5,000
Humbje: Kontributi nga porosia e rregullt	$(4,000 \times €3)$ 12,000
Kontributi neto - me pranimin e porosis së veçantë	€ (7,000)

Porosia e veçantë nuk duhet të pranohet.

b. $7,000€ / 10,000$ njësi = 0.7€/njësi

$7.5€ + 0.7€ = 8.2€$ /njësi

Problemi 4 (20 pikë)

(a) Materiali X përdoret nga kompania A në prodhim e njërit prej produkteve të saj, Produktin Z. Kërkesa për Produktin Z për vitin e ardhshëm parashikohet të jetë 30,000 njësi.

Secila njësi e përfunduar e Produktit Z përmban 0.82 kilogramë nga Materiali X. Gjatë prodhimit ka gjithmonë një humbje normale prej 15% të materialeve të përdorura. Nuk planifikohet asnjë ndryshim në nivelet e mbajtura të stokeve të Produktit Z në vitin në vijim, megjithatë planifikohet një rritje prej 1,000 kilogramësh në stoqet e Materialit X.

Kërkohet:

Llogarisni sasinë e Materialit X që duhet të blihet në vitin e ardhshëm. (Rrumbullakos vlerat)

(4 pikë)

(b) Materiali Y në të njëjtën kohë përdoret edhe në prodhimin e Produktit Z dhe në disa produkte të tjera. Kërkesa totale vjetore për Materialin Y është 160,000 litra, dhe kjo sasi përdoret në mënyrë të njëtrajtshme çdo vit.

Kostot e porositjes së stokeve dhe mbajtjes së tyre janë si vijon:

Porositja € 35 për porosi

Mbajtja € 0.50 për litër në vit

Për stoqet e Materialit Y duhet të ruhet një nivel i caktuar i sigurisë prej 3,500 litrash dhe koha mesatare që nevojitet për të marrë në dorëzim një porosi (pra intervali kohor midis dhënies së një porosie për materiale dhe dorëzimit të tyre) është 1.5 javë.

Kërkohet:

Për Materialin Y llogarisni:

- (i) Sasinë e porosisë ekonomike, duke përdorur formulën $\sqrt{[(2CoD) \div Ch]}$; (4 pikë)
- (ii) Nivelin pas të cilit duhet të porositet përsëri (supozoni se 1 vit = 50 javë); (4 pikë)
- (iii) Koston totale vjetore të porositjes së stokeve të materialit; (4 pikë)
- (iv) Koston totale vjetore të mbajtjes së stokeve të materialit. (4 pikë) (20 pikë)

Zgjidhja e problemit 4

$$\begin{aligned} \text{(a)} \quad \text{Sasia e përdorimit e Materialit X} &= (0.82 \div 0.85) \times 30,000 \times 0.82 \\ &= 28,941 \text{ kilogramë} \end{aligned}$$

$$\text{Blerja} = 28,941 + 1,000 = \underline{29,941 \text{ kilogramë}}$$

$$\text{(b)} \quad \text{(i) Sasia e porosisë ekonomike për Materialin Y}$$

$$= \sqrt{[(2 \times 35 \times 160,000) \div 0.5]}$$

$$= \underline{4,733 \text{ litra}}$$

$$\text{(ii) Niveli i ri – porositjes së Materialit Y}$$

$$= [(160,000 \div 50) \times 1.5] + 3,500 = \underline{8,300 \text{ litra}}$$

$$\text{(iii) Kostoja vjetore e porositjes për Materialin Y}$$

$$= (160,000 \div 4,733) \times 35 = \underline{€ 1,183}$$

$$\text{(iv) Kostoja vjetore e mbajtjes për Materialin Y}$$

$$[(4,733 \div 2) + 3,500] \times 0.5 = \underline{€ 2,933}$$

Problemi 5

1. (20 pikë)

- a. Gimi Co. operon në procesin e prodhimit të kostove dhe pret që humbja normale të jetë 25% e njësive hyrëse. Të gjitha humbjet kanë një vlerë si mbeturina prej 8€ për kg dhe nuk kemi stoqe në fillim dhe në fund të punës në proces në periudhë.

Detalet e mëposhtëme janë dhënë:

Hyrjet e Materialit	3,500 kg
Kostoja e Materialit	€52,500
Puna Direkte	€9,625
Njësit dalse aktuale	2,800 kg

a1. Kalkuloni vlerën e njësive dalëse në periudhë? (4 pikë)

a2. Kalkuloni vlerën monetare të pranuar nga mbeturinat e materialit për periudhën? (2 pikë)

- b. Semi Co. dëshiron të sigurohet se kostot e stoqeve janë duke u menaxhuar mirë. Kemi informatat në vijim të ndërlidhura me lëndën e parë në përdorim vjetor prej 4,000 njësi:

Çmimi i blerjes është €15 për njësi.

Secila porosi kërkon €5 kosto administrative dhe plus €50 për ngarkesën e shpërndarjes. Shpenzimet e magazinimit përbëhen nga pjesa fikse prej 20cent (0.2€) për njësi në vite dhe kostot variabile prej 10% e çmimit të blerjes për njësi në vite.

Kalkuloni ri porositjen optimale(ekonomike) në sasi (rrumbullakosni vlerat. (3 pikë)

- c. Eli Co. prodhon një seri të produkteve të ndryshme duke përdorur makineri automatike të sofistikuar. Kemi në dispozicion informatat e mëposhtme dhe dëshirojmë të përcaktojmë koeficientin e paracaktuar më të përafërt për absorbimin e shpenzimeve të përgjithshme të prodhimit (Shpp).

Informatat nga buxheti:

Shp. e përgjithshme të prodhimit fikse	€180,000
Orët e punës	3,000 orë
Orët e makinerisë	10,000 orë
Njësit e prodhimit	5,000 njësi
Kostot aktuale fikse	€160,000

Kalkuloni koeficientin e paracaktuar të përvetësimit të Shp. përgjithshme (3 pikë)

- d. MOKI Co. ka buxhetuar shitjet 5,000 njësi për muaj dhe fitim kontributin për njësi €25 euro për njësi. Nëse marxhina e sigurisë është 20%, kalkuloni nivelin e buxhetuar të kostove fikse në periudhën e njëjte. (2 pikë)

e. Karta e kostos standardë është dhënë më poshtë për periudhën e fundit financiare:

€ për njësi

Çmimi i shitjes	50
Materiali Direkt	4
Puna Direkte	16
Shpenz. Përgjithshme fikse	5
Shpenz. Përgjithshme variabile	10
Kostot fikse të shitjes	1
<u>Kostot variabile të shitjes</u>	<u>1</u>
Kosto totale	37
Njësit e buxhetuara të shitjes	3,000
Njësit Aktuale të shitjes	3,500

Kalkuloni Variancën e vëllimit të shitjes, sipas trajtimit marxhinal (Variabil) të kostove. (4 pikë)

Zgjidhja 5

1.

a1.

Gimi Co. -	Llogaria e Procesit			
	Kgs	€	Kgs	€
Materialet	3,500	52,500	Nj. Dal. aktuale 2,800	58,800
Puna		9,625		
Fitimi jonormal	175	3,675	Humja Norm. 875	7,000
	3,675	65,800	3,675	65,800

$$\text{Kosto për njësi} = \frac{52,500 + 9,625 - 7,000}{3,500 - 875}$$

= €21 për njësi dalëse.

$$\text{a2. Mbeturinat aktuale} = 3,500 - 2,800 = 700 \text{ kg} \times €8 = €5,600.$$

$$\text{b. Sasia e Porosisë Ekonomike} = \sqrt{\frac{2C_0D}{C_H}} = \sqrt{\frac{2 \times 4,000 \times (50 + 5)}{(15 \times 10\%) + 0.20}} = 509 \text{ njësi (Rrumbullaksim)}$$

c. Orët e Makinerisë janë më të përafërta për përcaktimin e Shk. Paracaktuar të Absorbimit €180,000 / 10,000 orë = €18 për orë makinerie .

d. Marxhina e sigurisë prej 20% është e barabartë me 1,000 njësi në muaj. Pika e Rentabilitetit është 4,000 njësi (5,000 - 1,000). Pasi që fitimi kontributi është i barabartë me kostot fikse (25 x 4,000) , kostot fikse do të jenë €100,000.

e.

	€ për njësi
Çmimi i shitjes	50
Materiali Direkt	4
Puna Direkte	16
Sh.p.p. Variabile	10
Kostot e shtijes variabile	1
Total kostot variabile	31
Fitim Kontributi	19
Varianca në njësi (3,000 - 3,500)	500 Fav
Varianca e vëllimit të shitjeve (500 x 19)	€9,500 Fav